



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.11.2023, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Klotilda Bushka – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore për projektligjin “Për buxhetin e vitit 2024” me institucionet:

Prokurorinë e Përgjithshme

KQZ-në

SPAK-un

Shkollën e Magjistraturës

Komisionin e Prokurimit Publik

Marrin pjesë:

Klotilda Bushka, Jurgis Çyrbja, Klevis Xhoxhi, Toni Gogu, Damian Gjijnuri, Saimir Hasalla, Aurora Mara, Lavdrim Krrashi, Eduard Ndreca, Arben Pëllumbi, Bardhyl Kollçaku, Olta Xhaçka, Petro Koçi, Xhemal Qefalia, Denis Deliu, Arkend Balla, Dhurata Çupi, Greta Bardeli, Saimir Korreshi, Fatmir Xhafaj, Gledis Çeliku, Ermonela Felaj, Oerd Bylykbashi, dhe Dashnor Sula.

Mungojnë:

Enkelejd Alibeaj, Bledion Nallbati, Pandeli Majko, Elda Hoti, Fatmir Mediu, Erisa Xhixho, Gerta Duraku dhe Gazment Bardhi.

Të ftuar:

Thoma Jano – zëvendësprokuror i Përgjithshëm

Luan Abazi – sekretar i Përgjithshëm i Prokurorisë së Përgjithshme
Valentina Azizaj – përgjegjëse e Buxhetit në Prokurorinë e Përgjithshme
Altin Dumani – drejtues i Prokurorisë së Posaçme
Klodjan Braho – drejtues i Seksionit kundër Korrupsionit në Prokurorinë e Posaçme
Fabian Zhilla – këshilltar ligjor në kabinetin e drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme
Armand Shini – drejtor i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Prokurorinë e Posaçme
Ela Qokaj – kancelare e Shkollës së Magjistraturës
Fiorent Zguro – anëtar i Komisionit të Prokurimit Publik
Rudina Prifti – përgjegjëse e Sektorit të Financës, Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve në Komisionin e Prokurimit Publik
Ilijan Celibashi – Komisioner Shtetëror i Zgjedhjeve
Enkeleon Topulli – drejtor i Buxhetit në KQZ
Vilma Çauholli – përgjegjëse Sektori në Drejtorinë e Analizës dhe Programimit Buxhetor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Klotilda Bushka – Mirëdita, kolegë!

Nisim mbledhjen e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut me rendin e ditës sipas njoftimit.

Sot në rendin e ditës kemi seancë dëgjimore për projektligjin “Për buxhetin e vitit 2024” me institucionet e pavarura. Pra, sot kemi seancë dëgjimore me Prokurorinë e Përgjithshme, me Strukturën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, me Shkollën e Magjistraturës dhe me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Prezentë kemi zonjën Vilma Çausholli, përgjegjëse Sektori në Drejtorinë e Buxhetit në Ministrinë e Financave. Relatorë për këtë projektligj kemi kolegët Klevis Xhoxhi dhe Saimir Hasalla.

Pa humbur kohë, fillojmë dëgjesën me Prokurorinë e Përgjithshme. Ata janë *online*. Nuk e di nëse dëgjohemi.

Të ftuar nga Prokuroria e Përgjithshme kemi zotin Thoma Jano, zëvendësprokuror i Përgjithshëm, zotin Luan Abazi, sekretar i Përgjithshëm dhe zonjën Valentina Hazizaj, përgjegjëse e Buxhetit.

Fjalën do t’ia kaloj zotit Jano.

Thoma Jano – Mirëmëngjesi!

Klotilda Bushka – Mirëmëngjesi, zoti Jano! A mund të dilni me figurë, se ju dëgjojmë vetëm me audio?

Zoti Jano, na bëni një prezantim të treguesve buxhetorë të vitit 2023 dhe realizimin e tyre, si dhe një prezantim të buxhetit të vitit 2024, pra, se sa janë adresuar në projektligjin që po shqyrtojmë, nevojat që ju keni, shtesat, nëse keni, si dhe argumentet tuaja, më pas fjalën do ta marrin relatorët dhe Ministria e Financave.

Fjala për ju, zoti Jano.

Thoma Jano – Faleminderit!

Prokuroria e Përgjithshme vjen sot para Komisionit të Çështjeve Ligjore për të raportuar lidhur me projektbuxhetin afatmesëm. Prokuroria e Përgjithshme e ka përgatitur dokumentin dhe e ka dërguar në komision. Në vijim do të dëgjoni sekretarin e Përgjithshëm, zotin Luan Abazi, për të detajuar projektbuxhetin.

Klotilda Bushka – Dakord, faleminderit!

Po, zoti Abazi.

Luan Abazi – Përshëndetje!

Të nderuar deputetë,

E nderuar zonja kryetare,

Prokuroria e Përgjithshme, në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore që normojnë planifikimin buxhetor afatmesëm, ka kryer të gjithë hapat që përcaktohen në bazë të këtyre akteve. Për ekonomi kohe nuk po i lexoj referencat ligjore ku jemi bazuar për hartimin e projektbuxhetit, por po ndalem në momentet kryesore që pasqyrojnë kërkesat tona për projektbuxhetin e vitit 2024.

Në lidhje me numrin e punonjësve dhe fondin e pagave, dua të veçoj një moment ku ne kemi kërkuar 15 shtesa, mbi bazën e urdhrin të ministres së Financave, por kemi rakorduar me Ministrinë e Financave dhe e tërheqim këtë shtesë prej 15 punonjësish, për arsye të rikualifikimit të veprimeve mes nesh dhe Ministrisë së Financave.

Pagat e punonjësve të Prokurorisë së Përgjithshme

Vitin e kaluar në Komisionin e Ligjeve kemi diskutuar për problematikën që ka lindur me pagat, për shkak të gabimit që u bë me pagën e prokurorëve dhe oficerëve të Policisë Gjyqësore. Gjatë këtij viti, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, kemi marrë të gjitha masat për të ulur detyrimin që kemi ndaj punonjësve tanë për këtë problematikë të konstatuar.

Problem në vijim ngelet pagesa e të gjithë detyrimit që kemi ndaj punonjësve. Proceset gjyqësore mes institucionit dhe punonjësve vazhdojnë dhe gjykata në mënyrë sistematike po shprehet në favor të punonjësve. Nga ana jonë është njohur detyrimi për të gjithë punonjësit, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese, por edhe për të kursyer burimet njerëzore që shkojnë çdo ditë në gjyq, për të kursyer shpenzimet gjyqësore dhe shpenzimet e përmbarimit, që kapin një shumë të madhe.

Gjatë kësaj periudhe ne kemi qenë shumë në vështirësi në kryerjen e veprimeve financiare me Thesarin, pasi nga ana e përmbaruesve është bllokuar Thesari për shkak të detyrimeve që kemi ndaj punonjësve. Ndaj do të ishte me vend që të rivlerësohet edhe një herë situata dhe t'i kërkohej Ministrisë së Financave likuidimi i detyrimit që kemi ndaj punonjësve, pasi Prokuroria është në vështirësi të përditshme për të kryer veprimet e saj kushtetuese. Pra, në çdo veprim që kryejmë për pagesat e ekspertëve dhe të gjitha detyrimeve që kemi, kemi

vështirësi nga vendimet e përmbarimit. Ju lutem, rivlerësojeni situatën, që kjo gjë të shkojë në normalitet sa më shpejt.

Megjithatë, nga takimet e vazhdueshme me Ministrinë e Financave na është premtuar se kjo situatë do të rregullohet, por kërkoj të rregullohet sa më shpejt që situata të shkojë drejt normalitetit.

Për sa u përket shpenzimeve operative, në pamje të parë buxheti ka rritje. Kjo rritje, nëse krahasohet me detyrat funksionale që kemi, është e pranueshme. Por, gjatë këtij viti është bërë edhe një marrëveshje mes Ministrisë së Financave dhe shoqërisë së ruajtjeve të objekteve “Illyrian Guard”, e cila rrit shpenzimet për ruajtjen e objekteve. Ne kërkojmë që kjo rritje e pagesës për këtë kompani të shoqërohet me rritje të buxhetit.

Gjithashtu, kemi pasur kontakte me Komisionin e Ligjeve dhe për vite e vite me radhë kemi ngritur si problem heqjen e pagesave mes institucioneve, kryesisht për aktet e Mjekësisë Ligjore. Ne jemi në dijeni që është duke u diskutuar një projektligj për Mjekësinë Ligjore, ndaj kërkojmë që në këtë projektligj të hiqen pagesat mes institucionit të Prokurorisë dhe Mjekësisë Ligjore. Ne kemi eksperiencë të tilla me zjarrfikësit dhe me laboratorin e kriminalistikës. Mjekësia Ligjore dhe ASHK-ja për aktet që kërkojmë për shkak të hetimit kanë vendosur pagesa, të cilat e rëndojnë në mënyrë sistematike buxhetin e Prokurorisë.

Gjendja e detyrimeve të palikuiduara të Prokurorisë të datës 31.08.2023, është rreth 103 milionë lekë. Pra, ajo shtesë që ne kërkojmë për shpenzime operative, shkon për likuidimin e këtyre detyrimeve.

Për sa u përket investimeve, shuma e caktuar për investime për vitin 2024 na i plotëson nevojat. Por, duke ditur situatën tejet të vështirë të Prokurorisë së Tiranës dhe të disa prokurorive të tjera, nëse bashkia do të na caktonte një shesh ndërtimi, atëherë ne do të kërkonim një shtesë përgjatë vitit 2024 për të bërë projektin e godinës së Prokurorisë së Tiranës. Prokuroria e Tiranës është në një distancë të largët me gjykatën. Prokurorët shkojnë çdo ditë nga prokuroria në gjykatë, duke humbur kohë dhe duke u vënë në vështirësi.

Ideja është, dhe ka qenë, që të ndërtohet një godinë e përbashkët e Prokurorisë, e Gjykatës, Prokurorisë së Apelit dhe e Gjykatës së Apelit, ndaj së bashku me KLGJ-në dhe Bashkinë e Tiranës kemi ngritur një grup të përbashkët pune. Kjo do të sillte një përmirësim tërësor të situatës ku ndodhen sot prokuroria dhe gjykata. Ndaj e quajmë të arsyeshme që në këtë pikë të kemi mbështetjen tuaj.

Po u rikthehem edhe një herë detyrimeve që kemi ndaj punonjësve. Gjykata, ne dhe të gjitha institucionet që preken nga ky ndryshim kërkojnë që ky fond të jepet menjëherë dhe të jetë i unifikuar për të gjitha institucionet, jo për një institucion ndryshe dhe për një institucion tjetër ndryshe.

Ne kemi bërë diçka, por jo për ta mbyllur këtë problem. Shpenzimet gjyqësore po rriten çdo ditë, kamatëvonesat për pagat e vonuara shkojnë 10% të totalit dhe po rriten çdo ditë, ndaj kërkojmë mbështetjen tuaj në këtë pikë.

Kaq kishim në tërësi për projektbuxhetin e vitit 2024.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Abazi!

Për të gjitha çështje që ngritët, edhe relatorët, edhe Ministria e Financave do të kenë qëndrimet e tyre. Në fund edhe unë do ta marr fjalën për të bërë një përmbledhje, por si fillim do t'ia jap fjalën zotit Xhoxhi.

Klevis Xhoxhi – Faleminderit, zonja kryetare!

Falënderoj përfaqësuesit e Prokurorisë së Përgjithshme për prezantimin e kërkesave të buxhetit!

Më lejoni të them se projektbuxheti i vitit 2024 është një mbështetje për gjithë reformën në drejtësi dhe për institucionet në veçanti. Edhe për Prokurorinë e Përgjithshme buxheti total, i parashikuar për vitin 2024, është rreth 3,2 miliardë lekë, nga të cilat 2,75 miliardë lekë janë shpenzime për pagat dhe sigurimet shoqërore, 358 milionë lekë janë shpenzime për mallra e shërbime dhe 130 milionë lekë janë shpenzime për investime.

Numri i punonjësve në Prokurorinë e Përgjithshme për vitin 2024 parashikohet të jetë 962 punonjës. Po të bëjmë një krahasim me realizimin e buxhetit të vitit 2023 me atë të vitit 2024, kemi një rritje me rreth 572 milionë lekë ose 21,5% më shumë, nga të cilat shpenzimet për paga janë rritur me 694 milionë lekë ose 33,8% më shumë, për mallra e shpenzime kemi një rënie me 41,8 milionë lekë ose 10,4% më pak dhe shpenzimet për investimet kanë një rënie me 80 milionë lekë. Numri i punonjësve nuk ka ndryshuar.

Duke i referuar fondeve për realizimin e buxhetit për 9-mujorin e parë të vitit 2023, kemi një realizim prej 86,4% për paga dhe sigurime shoqërore, shpenzime për mallra e shërbime në masën 57,3% dhe shpenzime për investime në masën 8%.

E përmendi edhe përfaqësuesi i Prokurorisë: kërkesa që është bërë për shtesa, mbi tavanet buxhetore të parashikuara në projektbuxhetin e paraqitur nga Këshilli i Ministrave, është

në vlerën 1,2 miliardë lekë. Nga të cilat 1,1 miliardë lekë janë shtesë për fondin e pagave, pra për pagat e prapambetura në zbatim të Gjykatës Kushtetuese, dhe 100 milionë lekë janë shtesa në zërin “mallra e shërbime” për kërkesat e palikuiduara për ekspertë të ndryshëm, shpenzime të rritura për shërbimin e ruajtjes fizike të godinës, si dhe fatura që u detyrohen përmbaruesve e kështu me radhë.

Përfaqësuesi i Prokurorisë kërkoi ndërmjetësimin e Komisionit të Ligjeve me Bashkinë e Tiranës që t’u vendosë në dispozicion një shesh për ndërtimin e godinës së re të Prokurorisë dhe Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës e Prokurorisë së Apelit, Tiranë.

Të nderuar kolegë, kjo ishte një panoramë e shkurtër e realizimit të buxhetit të vitit 2023 dhe parashikimi i projektbuxhetit të vitit 2024. Në rakordim me Ministrinë e Financave dhe me sugjerimet tuaja, të nderuar kolegë, do të shikojmë mundësinë që të rakordojmë për kërkesat e Prokurorisë së Përgjithshme për projektbuxhetin e vitit 2024 dhe t’ia paraqesim si sugjerim në raport Komisionit të Ekonomisë.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Xhoxhi!

Fjala është për zonjën Çausholli.

Vilma Çausholli – Faleminderit, zonja kryetare!

Edhe unë dua të vendos theksin se në buxhetin e vitit 2024 për Prokurorinë e Përgjithshme është marrë në konsideratë domosdoshmëria e zhvillimit të veprimtarisë normale në institucion dhe për të mbuluar të gjitha shpenzimet e domosdoshme në realizimin e kësaj veprimtarie operationale. Dua të theksoj se Prokuroria e Përgjithshme për vitin 2024 ka një rritje të ndjeshme në fonde, pavarësisht se pjesa kryesore e rritjes së fondeve shkon në shpenzimet për pagat. Pra, rreth 700 milionë lekë i janë akorduar për vitin 2024 Prokurorisë së Përgjithshme, që shkojnë për realizimin reformës së pagave si për magjistratët, ashtu edhe për administratën.

Ka një rritje të vogël në shpenzimet operative, doja ta saktësoja këtë pjesë, pasi krahasimi që bëri relatori lidhet me aktin normativ të vitit 2023. Unë dua të them se në aktin normativ të vitit 2023 janë ndryshimet që bëhen në buxhet për arsye të ndryshme, që nuk mund të jenë vijueshme gjithmonë. Pra, janë shpenzime që shtohen, por që nuk është e thënë që këto shpenzime do të jenë gjithmonë të vijueshme edhe në vitin 2024. Për këtë arsye ne bëjmë krahasimin me atë që e quajmë “buxhet fillestar” apo buxhet të një funksionimi normal të institucionit dhe pavarësisht se rritja është minimaliste ka një rritje në shpenzimet operative me

3,6 milionë lekë. Sigurisht, unë do të vlerësoja se nga Prokuroria e Përgjithshme kërkesa prej 102 milionë lekësh, që është një shumë e konsiderueshme, të rivlerësohet edhe një herë në dy drejtime:

Së pari, në reduktimin e shpenzimeve për Ilyrian Guard, pra në shpenzimet e ruajtjes. Sigurisht, që rritja pagës minimale çoi në rritje të tarifave të ruajtjes për këtë shoqëri dhe automatikisht në një shpenzim të rritur për Prokurorinë e Përgjithshme. Me anë të një marrëveshjeje apo një diskutimi me Ilyrian Guard, institucioni i Prokurorisë duhet të shikojë mundësinë e realizimit të kësaj ruajtjeje me një kosto më të ulët nëpërmjet metodologjisë të përcaktuar nga Ilyrian Guard jo vetëm me roje fizike, por edhe nëpërmjet mjeteve të tjera që ajo ka për ruajtjen, nëse është e mundur, me qëllim reduktimin e kësaj kostoje.

Së dyti, duhet të rivlerësohet edhe kërkesa për shpenzimet, që lidhen me mjekësinë ligjore. Besojmë se ky problem tashmë është drejt zgjidhjes dhe për vitin 2024 nuk do të jenë më këto kërkesa nga ky institucion, siç është mjekësia ligjore.

Lidhur me investimet nuk kemi asnjë koment për sa kohë që institucioni është dakordësuar për fondin e akorduar, pasi janë kryesisht investime, që janë në projekte në vazhdim dhe kjo është një gjë shumë e mirë për ne. Pra, ende janë të paplotësuara këto shpenzime të projekteve në vijim dhe nga institucioni nuk është kërkuar fond ndërtim të reja. Kjo vlen për t'u lavdëruar nga institucioni i Prokurorisë së Përgjithshme.

Në përfundim, mendoj se mund të rivlerësohej edhe një herë kërkesa për shpenzime operative të institucionit të Prokurorisë së Përgjithshme.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zonja Vilma!

Kush e kërkon fjalën nga kolegët? Nuk ka.

Atëherë, më duhet të bëj një përmbledhje.

Unë kam përpara relacionet përkatëse nga Drejtoria e Monitorimeve të Kuvendit, relacionin e relatorit, relacionin e ligjit “Për buxhetin e vitit 2024” dhe shkresën që ka ardhur nga Prokuroria e Përgjithshme për sa u takon nevojave shtesë. Kjo shkresë, siç po thotë edhe sekretaria, u është shpërndarë anëtarëve të komisionit.

Në lidhje me shqetësimin që ngre me të drejtë Prokuroria e Përgjithshme, që bllokohet një llogari buxheti për efekt të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, kjo është, në fakt, për t'u

vlerësuar. Kjo lidhet me pagesat e prapambetura të pagave që vijnë si rrjedhojë e vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

Unë ua kam shpjeguar edhe institucioneve të tjera në këto dëgjesa, që kanë të gjithë të njëjtin shqetësim që Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë dhe ne, si Komisioni i Ligjeve, së bashku me institucionet e drejtësisë dhe me organet e tjera të pavarura që afektohen nga kjo çështje, brenda vitit do të gjejmë një zgjidhje institucionale ligjore për këtë çështje. Pra, në buxhetin e vitit 2024, që ju e ngrini si shqetësim, ndoshta kjo gjë do të rishikohet, por jemi ende pa u mbyllur viti 2023 dhe jemi duke menduar një zgjidhje ligjore institucionale për të cilën do të ketë edhe një takim zyrtar me të gjithë përfaqësuesit e institucioneve për sa i takon kësaj çështjeje. Kjo është një çështje shqetësuese dhe unë u jap të drejtë në këtë drejtim.

Për sa i takon çështjes së financimit të ekspertizave, ne kemi buxhetuar në vitin 2023 ekspertizat përkatëse dhe do të duhet të vijojmë edhe në vitin 2022 kështu. Ndaj, e falënderoj zonjën Çausholli, që është e hapur në këtë drejtim, sepse këto janë nevoja që lidhen me ushtrimin e funksioneve dhe janë të domosdoshme si shpenzime.

Nga ana tjetër, zoti Abazi, meqenëse ju përmendët se po bëhen ndryshime ligjore për sa i takon Institutit të Mjekësisë Ligjore, besoj se ju jeni pjesë e konsultimeve dhe do të shpreheni atje në lidhje me qëndrimin që keni për sa u takon çështjeve që ngritët këtu që kanë natyrë buxhetore. Ne do ta ndjekim, gjithashtu, këtë çështje, por për sa kohë ajo është në proces ne do të duhet ta zgjidhim tani për 2024-ën. Kështu që në këtë aspekt unë do t'u kërkoja relatorëve, institucionit të Prokurorisë dhe Ministrisë së Financave të rakordojnë që shpenzimet e ekspertizës të të gjitha natyrave, siç kemi bërë në vitin 2023, të parashikohen në buxhetin e ri për vitin 2024.

Për çdo kërkesë të ardhur, në fakt, do të duhet të rakordohen së bashku Ministria e Financave me Prokurorinë e Përgjithshme dhe me relatorët në mënyrë që kur komisioni të behje shqyrtimin nen për ne dhe në tërësi të projektligjit dhe sugjerimet tona të diskutohen në Komisionin e Ekonomisë ne të kemi një qartësi sipas asaj që unë e përsëris gjithmonë si prioritet, ato që janë shpenzime të domosdoshme për ushtrimin e funksioneve, ato që do të duhet të realizohen në kuadër edhe të mundësive buxhetore që ka buxheti i shtetit. Ndaj, duhet të jeni shumë të qartë kur të na paraqisni argumentet dhe këtë e kam për relatorët dhe për institucionin.

Kishte edhe një çështje tjetër për sa i takon godinës. Ju keni të njëjtin shqetësim që ka ngritur edhe Këshilli i Lartë Gjyqësor për Gjykatat e Tiranës. Ne kemi kërkuar nga KLGJ-ja një

shkresë për të gjitha nevojat që kanë për godina apo për pasuri të paluajtshme për realizimin e ndërtesave të reja në kuadër edhe të zbatimit të hartës së re gjyqësore, por edhe për nevojat që kanë për kushte pune optimale në gjykata, ashtu edhe nga ana juaj kërkojmë të na sillni një kërkesë me shkrim në lidhje me këtë çështje, sepse për eficiencë, ndoshta kur Komisioni i Ligjeve të bëjë punën e tij, duke kërkuar nga institucioni i Bashkisë së Tiranës që t'u përgjigjet nevojave tuaja, të shikojmë edhe mundësinë e ambienteve të përbashkëta pra që të kemi sa më pak kosto në investime.

Për sa u takon pastaj investimeve që ju kërkonin unë mendoj se Ministria e Financave e dha qëndrimin e saj dhe këto do të duhen parë në rakordim midis jush, Ministrisë së Financave dhe relatorëve.

Shikoj, në fakt, që zërin e treguesve të realizimit të buxhetit për investime e keni vetëm 8% në vitin 2023 dhe shifra këto janë për 9-mujorin e parë. Nuk e di nëse kjo shifër është rritur, por duhet të keni parasysh se treguesit buxhetorë të një viti më parë janë ato që merren për bazë për planifikim buxhetor të vitit pasardhës. Kështu që kur të bëni rakordimet për kërkesat që keni, duhet të keni në konsideratë edhe këtë fakt. Pra, argumenti do të jetë ky dhe e themi shpesh se një investim i pakryer, pra i njohur në një buxhet, i pakryer gjatë atij viti ka rezultuar joeficientë, sepse ky investim mund të përdorej për një nevojë tjetër që ka shteti.

Kështu që do t'ju lutesha, jo vetëm juve si Prokurori e Përgjithshme, por të gjitha institucioneve që janë në fushën e përgjegjësisë së Komisionit të Ligjeve, të jenë të kujdesshme në këtë aspekt. Patjetër që ka edhe shkaqe objektive, ne nuk po paragjykojmë këtu, sepse janë pjesë e diskutimeve herë pas here edhe pengesat që hasen për realizimin e investimeve, por do të duhet që kjo të jetë në konsideratë nga atë gjitha institucionet, në mënyrë që edhe ne të kemi një planifikim sa më eficientë të fondeve, rezultate sa më të mira dhe, nga ana tjetër, të vendosim një standard të njëjtë për të gjitha institucionet.

Atëherë, shikoj që nuk ka kërkesa për ta marrë fjalën për këtë pikë të rendit të ditës.

Zoti Abazi, zoti Jaho, zonja Çausholli, relatorët, koordinohuni institucionalisht për sqarimin dhe argumentimin e kërkesave dhe mundësve buxhetore duke u bazuar te rralla e prioriteteteve dhe më pas ne do të shqyrtojmë në mbledhjen përkatëse të Komisionit të Ligjeve se cilat sugjerime do t'i kalojnë Komisionit të Ekonomisë.

Faleminderit!

Zotërinjtë e Prokurorisë së Përgjithshme janë të lirë të shkojnë.

Vazhdojmë me dëgjesën tjetër, me Strukturën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

Atëherë, *online* janë zoti Altin Dumani, drejtuesi i SPAK-ut, zoti Klodian Braho, drejtues i Seksionit kundër Korrupsionit, zoti Fabjan Zhilla, këshilltar ligjor i Kabinetit të Drejtuesit të SPAK dhe zoti Armand Shini, drejtor i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar.

Mirë se erdhët, zoti Dumani, bashkë me kolegët e tjerë, në mbledhjen e Komisionit e Ligjeve!

Ju ishin prezentë dhe e ndoqët fillimin e mbledhjes, pra e dini mënyrën se si zhvillohet dhe se si veprimet kur bëjmë shqyrtimin e projektligjit për buxhetin e vitit. Nga ana juaj duhet të kuptojmë si janë treguesit e realizimit të buxhetit të vitit 2023, nëse nevojat për vitin 2024 janë adresuar në projektligj dhe nëse ju keni shqetësime të tjera, që kërkonin t'i ndani me Kamionin e Ligjeve dhe kërkesa të tjera, plus atyre të parashikuara në projektligj.

Fjala për ju, zoti Dumani, ose dikush tjetër nga kolegët tuaj që ndodhen aty.

Teknika, ju lutem, mundësoni fjalën për zotin Dumani.

Altin Dumani – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Faleminderit, zonja Bushka!

Të nderuar deputetë,

Ne jemi njohur me projektbuxhetin e vitit 2024 dhe përgjithësisht i gjejmë të adresuara kërkesat e institucionit tonë, por vlerësojmë se ka vend për pranimin e kërkesave në lidhje me zërin e investimeve dhe shpenzime për paga. Megjithatë, në mënyrë më të detajuar këto kërkesa do t'i parashtrijë para jush drejtori i buxhetit, zoti Shini.

Faleminderit!

Armand Shini – E nderuara kryetare,

Të nderuar deputetë,

Në vija të përgjithshme buxheti i vitit 2024 për SPAK-un është fokusuar në financimin e shpenzimeve për përmbushjen e objektivave prioritare strategjike, si: në përmirësimin e cilësisë së aktiviteteve të institucionit, si dhe paraqitjen e një produkti hetimor cilësor, që përkthehet në raste të suksesshme të përfunduara dhe të dërguara për gjykim pranë Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar; në sigurimin e një infrastrukturës së nevojshme për kryerjen e proceseve të punës në shërbim të një trajtimi sa më efektiv të rasteve hetimore; në ofrimin e sigurisë fizike dhe financiare për personelin hetimor dhe administrativ të strukturës së

posaçme, si një garanci afatgjatë e integritetit kushtetues të institucionit, si dhe në pajisjen e punonjësve me bazën e nevojshme materiale si dhe krijimin e kushteve të përshtatshme të punës për punonjësit.

Ne jemi njohur me VKM-në nr.607 “Për krijimin e dokumentit të programit buxhetor afatmesëm 2024-2026”, të rishikuar”. Ky buxhet në përgjithësi i ka adresuar kërkesat tona buxhetore, por ka nevojë për disa kërkesa shtesë, që ne i kemi paraqitur më përpara.

Aktualisht, projektbuxheti i vitit 2024 parashikohet në vlerën 1,5 miliardë lekë, kjo e ndarë në zërin për paga, 979 milionë lekë, kontributet e sigurimet shoqërore, 123 milionë lekë, mallra e shërbime, 228 milionë lekë dhe investime, 250 milionë lekë. Ky buxhet, në fakt, nuk plotëson kërkesat e paraqitura nga ana jonë.

Në zërin e pagave kërkohet shuma 216 milionë lekë shtesë, në zërin mallra e shërbime 24 milionë lekë dhe në zërin e investimeve 309 milionë lekë, ndërsa kontributet e sigurimeve shoqërore e tejkalojnë kërkesën tonë në shumë 20 milionë lekë.

Për sa u përket pagave konstatojmë se ka një mangësi në financim në shumë 74 milionë lekë. Në zërin e pagave konstatojmë se nga Ministria e Financave nuk janë marrë parasysh efektet në pagën bruto të shpenzimeve për gatishmërinë, orët jashtë orarit apo shpërblimet për rezultatet në punë, këtu e kam fjalën për strukturën e BKH-së, në vlerën rreth 136,8 milionë lekë, si dhe diferenca të tjera të rezultuara nga llogaritja e vjetërsisë në punë dhe elemente të pagës mbi të cilën llogaritet vështirësia në punë për personelin administrativ.

Për sa u përket vendimeve gjyqësore për Prokurorinë e Posaçme, që janë në ekzekutim të përkohshëm, për të shmangur shpenzimet gjyqësore, shpenzimet përmbartimore, është e mira të gjendet një zgjidhje. Ashtu siç dëgjuam, kjo do të ishte një zgjidhje për të gjithë magistratët dhe mendojmë se do të jetë në vëmendjen tuaj.

Ne kemi paraqitur edhe kërkesat shtesë për efektet prapavepruese të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, e cila arrin në shumën 130 milionë lekë. Aktualisht, ne e kemi njohur si detyrim vendimin e Gjykatës Kushtetuese për një periudhë kohe dhe e kemi shlyer atë.

Lidhur me shpenzimet operative, unë ju përmenda shërbimet, ku vërehet një mosplotësim në kërkesën prej 24 milionë lekësh. Konstatojmë se nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë kjo është marrë në konsideratë, është adresuar dhe është rritur në krahasim me vitin e kaluar, por gjithsesi për shkak të shpenzimeve shtesë kjo nuk arrin ta plotësojë.

Çështja kryesore në kërkesat shtesë gjatë këtij viti paraqitet në zërin e investimeve. Si rrjedhojë e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 378, datë 21.6.2023, për marrjen në administrim, në përgjithësi për Ministrinë e Drejtësisë dhe për Prokurorinë e Posaçme, është marrë godina e re, e cila ka qenë ndërtuar nga ujësjellës-kanalizime sh.a. Kjo ndërtesë ka nevojë imediate për përshtatje për të mundësuar kalimin dhe transferimin e stafit të SPAK-ut pranë kësaj godine. Ne kemi bërë një parashikim të fondeve të nevojshme, të cilat konsistojnë te siguria dhe shtimi i elementeve të sigurisë, këto të paraqitura dhe të vlerësuara edhe nga Garda e Republikës, duke filluar nga skanerat, urat e dedektimit, muri rrethues, duke ruajtur edhe planimetrinë dhe ndërhyrjet e brendshme. Kjo godinë ka qenë e planifikuar për ujësjellësin kështu që ka shumë hapësira *out space*, ndërhyrjet në serverë dhe në infrastrukturën e teknologjisë ku të gjitha këto investime kanë kërkuar një vlerë prej 500 milionë lekësh plus 50 milionë lekë që kanë qenë të parashikuara.

Në VKM-në nga projektbuxheti shohim se këtë vit në zërin e investimeve është miratuar një fond prej 250 milionë lekësh dhe për vitin pasardhës një shumë prej 420 milionë lekësh, pra për vitin 2025. Për ne është e nevojshme që investimi të jetë gjatë vitit 2024, pasi nëse do të fillojnë investimet nuk mund të copëzohet. Pra, për investimin e parashikuar, edhe pse e gjithë vlera e investimit është marrë në konsideratë dhe është për të mirë, duhet që ky investim të bëhet gjatë vitit 2024. Kjo është kërkesa kryesore sa u përket kërkesave shtesë të Prokurorisë së Posaçme që lidhen me zërin e investimeve. Sigurisht që marrja e godinës së re ka edhe kërkesa të tjera, siç janë ato në zërin e shpenzimeve operative ku shtohen edhe shpenzime të tjera, prandaj janë paraqitur edhe disa kërkesa shtesë sa i takon zërit të shpenzimeve.

Ajo çka ne insistojmë dhe për të cilën do të kërkonim mirëkuptimin tuaj lidhet me plotësimin e zërit të investimeve, për shkak se aktualisht Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar punon në ambiente të tejmbushura me staf dhe për këtë arsye ka nevoja imediate për krijimin e elementeve të sigurisë të asaj godine, por edhe për transferimin dhe punonjësve në kushte sa më të mira. Krahas kësaj kjo do të mundësonte edhe plotësimin me staf të plotë nga Byroja Kombëtare e Hetimit, si dhe mundësimin e oficerëve të Policisë Gjyqësore, një staf prej 50 personash.

Këto ishin në vija të përgjithshme kërkesat shtesë të paraqitura nga Prokuroria e Posaçme.

Lidhur me përqindjen e realizimit gjatë këtij viti përqindja e pritshme e realizimit, duke marrë në konsideratë pakësimet nga akti normativ, pritet të realizohet në masën 97%. Përqindja e realizimit deri më 9 nëntor është në masën 65%. Në zërin e investimeve pritet të realizohet në masën 100%, pasi procedurat e prokurimit për zërin e investimeve janë në vijim, në zërin e pagave në masën 96%, në zërin e shpenzimeve operative në masën 98%, ndërsa ndihma për raste fatkeqësie është në masën 100%.

Kaq ishin ato që kisha për t'ju thënë.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Shini!

Fjalën e ka zoti Xhoxhi.

Klevis Xhoxhi – Faleminderit, kryetare!

Falënderoj edhe përfaqësuesit e Strukturës së Posaçme Antikorrupsion dhe të Krimit të Organizuar për prezantimin e projektbuxhetit!

Në fakt, SPAK-u është një ndër institucionet e drejtësisë, i cili është mbështetur nga ana e qeverisë shqiptare. Buxheti për vitin 2024 për SPAK-un është rreth 1,58 miliardë lekë, nga të cilat 1,1 miliardë lekë janë shpenzime për pagat dhe sigurimet shoqërore, 228 milionë lekë janë shpenzime për mallrat dhe shërbimet dhe 250 milionë lekë janë shpenzimet për investimet. Sa u takon numrit të punonjësve për vitin 2024 është parashikuar të jetë në 271 punonjës.

Në krahasim me buxhetin e vitit 2023, sipas aktit normativ rezulton se kemi një rritje prej 580 milionë lekësh ose 58% më shumë në projektbuxhetin e vitit 2024, ku shpenzimet për pagat janë rritur në 278,1 milionë lekë ose 34% më shumë; shpenzimet për mallrat dhe shërbimet janë rritur me 118 milionë lekë ose 103% më shumë dhe shpenzimet për investime janë rritur me 183 milionë lekë. Numri i punonjësve mbetet i pandryshuar.

Po t'i referohemi realizimit të buxhetit të vitit 2023, sipas aktit normativ, sa i përket 9-mujorit të parë, kemi një realizim të shpenzimeve për pagat në masën 66%, shpenzimet për mallrat në masën 68%. Sa u përket shpenzimeve për investim, përfaqësuesi i SPAK-ut e theksoi se janë ende në proceset e prokurimit dhe të nënshkrimit të kontratave.

Struktura ka paraqitur edhe disa kërkesa, të cilat u prezantuan nga përfaqësuesi i saj, për shtesat mbi tavanet buxhetore të parashikuara në projektbuxhetin e vitit 2024, që kapin një vlerë totale prej 770 milionë lekësh. Siç e theksoi edhe përfaqësuesi i SPAK-ut, mbështetja më e madhe që kërkohet është sa i përket zërit të shpenzimeve për investime dhe zërit të shpenzimeve

për pagat që vijnë si efekt financiar nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese. Shifrat nuk po jua përmend, sepse i përmendi përfaqësuesi i SPAK-ut.

Kolegë, kjo është një panoramë e shkurtër e realizimit të buxhetit të vitit 2023 dhe e projektbuxhetit të vitit 2024. Pa diskutim, në rakordim edhe me Ministrinë e Financave, por edhe me sugjerimet tuaja, kërkojmë që t'i japim mbështetjen tonë kësaj strukture për ta çuar përpara luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Xhoxhi!

Zonja Çausholli, ju lutem, fokusohemi në fjalën tuaj te kërkesat që paraqiti përfaqësuesi i Strukturës së Posaçme, pasi zërat ne i kemi!

Vilma Çausholli – Faleminderit, zonja kryetare!

Sigurisht, unë nuk do të ndalem as në realizimin faktik dhe as në projektbuxhetin e miratuar për vitin 2024, sepse janë vetë shifrat që flasin. Ky është një buxhet i rritur me mbi 50% dhe kjo tregon edhe një mbështetje të madhe buxhetore për institucionin e SPAK-ut. Dua të shtoj se kësaj mbështetjeje i bashkëngjitet edhe një mbështetje tjetër, e cila pavarësisht se nuk shfaqet në të dhënat e buxhetit të Strukturës së Posaçme, një shtesë prej rreth 100 milionë lekë për shpenzime personeli dhe shpenzime operative për Gardën e Republikës së Shqipërisë, të cilët do të jenë kontribues në...

Nuk dëgjohe?

Klotilda Bushka – Zonja Çausholli, përveç zërit tuaj është edhe një zë tjetër.

Vilma Çausholli – Më falni!

Jemi në kushtet e përgatitjes së buxhetit dhe të gjithë jemi të shpërndarë nëpër komisione, prandaj na kuptoni për interferencat.

Doja t'ju thosha se krahas mbështetjes buxhetore që i është dhënë drejtpërsëdrejti Strukturës së Posaçme janë edhe 100 milionë të tjera që i janë dhënë Gardës së Republikës së Shqipërisë pikërisht në mbështetje të veprimtarisë së institucionit të Strukturës së Posaçme.

Në lidhje me kërkesat shtesë që janë paraqitur në zërin “paga”, përveç pagave të prapambetura, këtë diskutim pothuajse e kemi mbyllur, do të doja të ngrija çështjen e shpenzimeve që paraqiti drejtori i Financës së Strukturës në lidhje me orët e gatishmërisë, të cilat nuk janë të përfshira në shpenzimet e personelit. Doja të theksoja se kjo është një praktikë buxhetore.

Shpenzimet e personelit nga ana e Ministrisë së Financave përlllogariten mbështetur në treguesit si akte ligjore dhe nënligjore që janë të miratuara, sikurse është edhe struktura organike e institucionit me të gjithë elementet përbërës që parashikon ligji mbi pagën bruto të punonjësve të Strukturës së Posaçme. Të gjitha orët e tjera që lidhen me gatishmërinë, sikurse janë edhe shpenzimet për udhëtime dhe dieta, si dhe të gjitha shpenzimet e tjera që nuk lidhen drejtpërsëdrejti me pagën e personelit duhet të parashikohen dhe të likuidohen nga fondet e tjera të institucionit, fondet e shpenzimeve operative, të cilat për vitin 2024 kanë njohur një rritje në masën 100 milionë lekë.

Lidhur me investimet do t'ju thosha se kjo është një çështje që duhet të diskutohet dhe të analizohet, sepse janë parashikime për të cilat është e vështirë të gjykohet, nëse do të mund të realizohet si investimi i dhënë prej 250 milionë nga buxheti i vitit 2024, ashtu edhe pjesa shtesë prej 300 milionësh, pra shifra prej 550 milionë lekësh, të cilat do të duhet të analizohen edhe një herë nëse do të ishte e mundur përfshirja e tyre dhe më pas realizimi i tyre brenda vitit 2024, pasi kjo është një çështje shumë e rëndësishme. Nëse këto para jepen dhe kjo nuk do të realizohet, atëherë kjo do të ndikojë në një menaxhim joefektiv dhe jo me eficiencë të këtyre fondeve buxhetore të paraqitura.

Ky ishte komenti i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në lidhje me kërkesat e paraqitura nga kjo strukturë.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zonja Çausholli!

Kolegë, a dëshiron ndonjëri prej jush ta marrë fjalën për pyetje? Jo.

Për diskutime?

Po, zoti Kollçaku.

Bardhyl Kollçaku – Falënderoj përfaqësuesit e Strukturës së Posaçme Antikorrupsion, si dhe përfaqësuesen e Ministrisë së Financave dhe relatorët për shpjegimet e detajuara të buxhetit, sidomos për realizimin e vitit 2023, i cili na bën të besojmë se edhe buxheti që do t'i alokohet kësaj strukture në vitin 2024 do të ketë këtë pritshmëri realizimi!

Unë kam një pyetje të thjeshtë: a ka SPAK-u financim të huaj dhe a reflektohet në buxhetin që ne po kalojmë, siç e kanë edhe Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Drejtësisë? Me aq sa unë kam dijeni di që ka një mbështetje qoftë nga Bashkimi

European apo qoftë partneri ynë strategjik, prandaj doja të dija, nëse reflektohet në këtë projektbuxhet.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Kush do ta marrë fjalën përfaqësuesit e SPAK-ut apo zonja Çausholli?

Zoti Shini, nga SPAK-u.

Armand Shini - SPAK-u, zakonisht, ka financime nga partnerë të huaj, por gjatë këtij viti nuk ka pasur financime nga partnerë të huaj apo për vitin e ardhshëm, për këtë nuk kemi dijeni. Sigurisht që SPAK-u ka financime nga Eurojust, të cilat janë vlera në të vogla në shumën 20 mijë euro për çështje të përbashkëta hetimore, ku maksimumi kjo shifër kap vlerën 50 mijë euro. Një ndër financimet është edhe nga Agjencia e Aseteve të Sekuestruara dhe të Konfiskuara ku gjatë këtij viti ne kemi përfituar një vlerë prej 169 milionë lekësh. Nuk është pjesë e këtij projektbuxheti.

Klotilda Bushka – Faleminderit!

Albert Dumani – Zonja kryetare, a mundem?

Klotilda Bushka – Po, zoti Dumani.

Fjalën e ka zoti Dumani.

Albert Dumani – Faleminderit, zonja kryetare!

Ashtu siç jua thashë edhe në fillim, ne përgjithësisht i gjejmë të adresuara kërkesat që institucioni ynë ka për fondet buxhetore. Edhe në lidhje me zërin “investime”, po ta shohësh, duket qartë se është vullneti për të investuar, por është bërë një ndarje, një pjesë për vitin 2024 dhe një pjesë për vitin 2025. Bëhet fjalë për godinën që na është dhënë në përdorim. Mirë do të ishte mirë që neve të na jepeshin fondet e nevojshme buxhetore, me qëllim që këtë godinë ta kthejmë funksionale brenda vitit 2024. Kjo godinë bëhet funksionale, sipas parashikimeve tona, vetëm nëse do të na miratohet fondi i kërkuar. Ne tashmë gjendemi para faktit që godinën e kemi përballë zyrave tona, sepse e kemi afër, por vazhdojmë sërish dhe punojmë tej kapaciteteve, shumë persona në të njëjtën zyrë, dhe nuk mund të plotësojmë stafin apo organikën e miratuar, sepse nuk kemi realisht ambiente se ku t’i vendosim punonjësit tanë, prandaj kjo është kërkesa kryesore jona. Godinën e kemi, fondet na copëzohen në dy vjet, çka nuk mundëson bërjen tërësisht funksionale të godinës, që tashmë ne e kemi në përdorim.

Faleminderit!

Klotilda Bushka - Faleminderit, zoti Dumani!

Atëherë, nga diskutimet unë vë re që te buxheti i parashikuar për vitin 2024, që është rreth 1,58 miliardë lekë, ku ndahen 1,1 miliardë lekë shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore; 228 milionë lekë për mallra shërbime; 250 milionë lekë shpenzime për investime, kërkohet një shtesë, e cila i referohet pjesës së zërit të shpenzimeve nga pagat, për përballimin e efekteve financiare prapavepruese të vendimit të Gjykatës Kushtetuese; 24 milionë lekë në zërin e shpenzimeve për mallra dhe shërbime për përballimin e shpenzimeve në funksion dhe administrim nga strukturat e SPAK-ut, si dhe një pjesë e madhe është për investime, ku bëhet fjalë për vënien në punë brenda vitit 2024 të godinës së re, ish- godina e UKT-së u tha, që është tashmë nën administrimin e SPAK-ut.

Në fakt, duke parë treguesit buxhetorë, ne thamë, kemi të dhënat e 9- mujorit të parë, zoti Shini shpjegoi që ju do të jeni 100% për treguesit e realizmit buxhetor të vitit 2023 për investimet, por, në fakt, në relacionin përkatës shifra del e ulët për treguesit 9- mujor. Sigurisht, viti nuk ka mbaruar dhe, referuar të dhënave që ju paraqitët, investimet do të jenë të plota, ato që kanë mbetur për vitin 2023, çka është edhe një bazë për të bërë planifikimin e vitit 2024.

Për çështjen e investimit për ta vënë në punë godinën e re brenda vitit 2024, ne do të dëshironim që ju ta realizonit, sepse kuptohet që kushtet e punës në një institucion, me ngarkesën që ju keni, me natyrën specifike duhet të jenë optimale.

Kështu që, edhe me Ministrinë e Financave, nisur nga argumentimi i treguesve të realizmit të buxhetit të vitit 2023 për investime, nisur nga nevojat e institucionit, mundësitë tona buxhetore, ne e shohim që është e rëndësishme që kjo kërkesë e SPAK-ut të merret në konsideratë.

Gjithsesi, Ministria e Financave me institucionin e SPAK-ut dhe me relatorët duhet të rakordohen, në mënyrë që ne të kemi një qartësi kur të vendosim përfundimisht për sugjerimet që do t'i bëjmë Komisionit të Ekonomisë.

Sa u takon shpenzimeve për pagesat e prapambetura të pagave, ju ishit prezent, unë e shpjegova, është një përpjekje për t'u zgjidhur në mënyrë institucionale nga ana ligjore brenda këtij viti. Kjo çështje është për të gjitha institucionet, prandaj nuk po ndalem këtu.

Shoh që zëri i kërkuar për shpenzime dhe mallra nuk është ndonjë shumë që mund të ketë ndonjë efekt të madh, Ministria e Financave, nëse nuk gaboj, zonja Çausholli, e shprehu qëndrimin, kjo është një gjë që mund të merret në konsideratë.

Thënë këtë, unë do të dëshiroja që t'i kishim të qarta argumentet dhe qëndrimet e Ministrisë së Financave, ju lutem, në rakordim me institucionin e SPAK-ut, që të gjithë kolegët e komisionit, kur të vijë momenti, t'i shqyrtojmë këto kërkesa dhe ne të jemi në gjendje të gjykojmë drejt.

Nuk shoh të ketë më diskutime.

Zoti Dumani, jeni i lirë të shkoni bashkë me stafin.

Faleminderit që ishit prezent!

Klotilda Bushka – Vazhdojmë me dëgjuesën tjetër, me Shkollën e Magjistraturës. Nga Shkolla e Magjistraturës është prezente zonja Ela Qokaj, kancelare.

Mirë se erdhe, zonja Qokaj!

Takohemi çdo vit në mbledhjen e komisionit për nevojat e Shkollës së Magjistraturës. Meqenëse ishit edhe ju prezente në këtë mbledhje, na dëgjuat, dhe nuk po i përsërit ato që thashë për ekonomi kohe, fjala është për ju për prezantimin e realizmit të treguesve buxhetor të vitit 2023; nevojat që keni për vitin 2024, dhe sa janë përfshirë ato në projektligjin e buxhetit.

Zonja Qokaj, fjala për ju.

Ela Qokaj – Faleminderit!

Faleminderit për vëmendjen dhe kohën tuaj lidhur me çështjet e diskutimit të projektbuxhetit të vitit 2024 dhe për mbështetjen financiare që u jepni çdo vit institucioneve shtetërore!

Doja të sillja në vëmendje realizmin e buxhetit të vitit 2023. Sigurisht, ka qenë një buxhet, i cili ka mbuluar nevojat e Shkollës së Magjistraturës, nevojat e domosdoshme të saj, lidhur me aktivitetet kryesore të trajnimit profesional të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si në programin e formimit fillestar, ashtu edhe në atë vazhdues, por dhe në një nga drejtimet e tjera që shkolla operon, që lidhet me kërkimet shkencore dhe publikimet, që i bashkëngjitet trajnimit të magjistratëve gjatë ndjekjes së këtyre programeve.

Nëse do të flasim me shifra, këtë do t'ua lë ekspertëve, specialistëve, relatorit që i ka nxjerrë ato, por në vija të përgjithshme unë do të thosha se në planin vjetor të buxhetit sa i përket 9-mujorit, Shkolla e Magjistraturës e ka realizuar atë në vlerën 80% dhe pritet që deri në fund të vitit ta realizojmë në vlerën 100%. Kjo për arsyen se ky ka qenë një vit shumë aktiv sa i përket edhe çështjes së ndjeshme të pagës së magjistratit. Sikurse e kanë përmendur të tërë deri tani, edhe Shkolla e Magjistraturës e ka ndierë atë gjatë këtij vitit, sidomos në zërin 602 “Shpenzime

operative” për shkak të vendimeve gjyqësore që vijnë herë pas here nga kandidatët për magistratë, të cilët kanë përfunduar studimet apo janë gjatë ndjekjes së studimeve, dhe përfshihet në periudhën 2019-2022, që është periudha që ka efektuar këto diferenca.

Lidhur me projektbuxhetin e vitit 2024, kam një falënderim të veçantë për Ministrinë e Financës, sepse jemi dakordësuar në çdo etapë të përgatitjes së tij lidhur me shifrat dhe nevojat që Shkolla ka për të gjithë zërat e buxhetit. Unë them sot se rakordimi i të gjithë vlerës 469 milionë e 671 mijë lekë, si buxhet total për Shkollën e Magjistraturës për vitin 2024, lidhur me plotësimin e të gjithë aktivitetit të saj dhe domosdoshmërisë së këtij buxheti, është i mjaftueshëm dhe mendoj se nuk ka nevojë për kërkesa të tjera. Ne nuk kemi sjellë para jush asnjë kërkesë tjetër lidhur me buxhetin e vitit 2024 për këto zëra.

Por, sigurisht ju e patë, e kemi përmendur dhe në relacionin tonë, ne kemi një kërkesë lidhur me diferencat e pagave të bursave të magistratëve dhe të pedagogëve të brendshëm, që afektohen nga pagat për shkak të barazimit të pagës së tyre me magistratët e Apelit, por që ju dhatë një zgjidhje dhe një përgjigje, që shpresojmë të ketë përfundim të mirë brenda këtij viti.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit!

Ju kërkesën shtesë, që ia keni paraqitur komisionit, e keni për efekt të mbulimit të shtesave të pagave të prapambetura nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese? Kështu që, kjo do të hyjë te zgjidhja që do të bëhet për të gjitha institucionin.

Shoh që keni dhe një kërkesë për shtesë në zërin e transfertës për bursat e kandidatëve.

Ela Qoka - Bursa e kandidatëve magistratë afektohet nga paga e magistratit, sepse ata gjatë viteve të zhvillimit të trajnimit marrin bursë, e cila në vitin e parë është 30% e pagës fillestare të magistratit, në vitin e dytë është 40%, dhe në vitin e tretë është 50%, kështu që vjen nga kjo diferencë.

Klotilda Bushka – Është e qartë, pra bëhet fjalë për studentët që kanë qenë në shkollë gjatë kohës që është marrë vendimi i Gjykatës Kushtetuese. Unë mendova se ishte për studentët e rinj që prisnin.

Ela Qoka - Jo, ne flasim për efektet e periudhës 2019-2022.

Klotilda Bushka - Sepse shqetësimi im ishte që ne vitin e kaluar diskutuam për këtë, që nuk ishin llogaritur mirë bursat e studentëve.

Ela Qoka - Po, por ata kanë kaluar në një vlerë shumë të mirë.

Klotilda Bushka- Po, pra keni kërkuar të mos bëhet më diskutim kjo, sepse është një çështje e qartë. Më falni, ishte keqkuptimi im!

Zoti Xhoxhi, më pas zonja Çausholli.

Klevis Xhoxhi - Faleminderit!

Kolegë, buxheti total për vitin 2024 për Shkollën e Magjistraturës është 470 milionë lekë, nga të cilat 99, 8 milionë lekë janë shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore; 78 milionë lekë janë shpenzime për mallra dhe shërbime; 284 milionë lekë janë shpenzime për transfertat në buxhet, ku përfshihen bursat e studentëve të shkollës dhe 8 milionë lekë janë shpenzime për investime.

Numri i punonjësve të këtij institucioni për vitin 2024 është parashikuar të jetë 41. Po të bëjmë krahasimin e buxhetit të vitit 2023 me projektbuxhetin e vitit 2024, konstatojmë se ne kemi një buxhet të rritur prej 111 milionë lekësh, ose 31% më shumë, nga të cilat shpenzimet për paga dhe sigurime janë rritur me rreth 20 milionë lekë ose 25% më shumë, shpenzime për mallra dhe shërbime janë rritur në 12,6 milionë lekë ose 19,4% më shumë, gjithashtu, transfertat ka pësuar një rritje prej 80 milionë lekësh ose 39% më shumë, ndërsa shpenzimet për investime kanë një rënie me 1 milion lekë.

Referuar të dhënave që kemi për realizmin e buxhetit të vitit 2023, sipas aktit normativ për 9-mujorin e parë, konstatojmë se kemi një realizmin në masën 89% për pagat e sigurimeve shoqërore; në masën e 45% për mallra dhe shërbime, dhe vetëm në masën 7 % kemi realizmi të shpenzimeve për investime.

Shkolla e Magjistraturës ka paraqitur edhe dy kërkesa, të cilat përfaqësuesja e Shkollës i parashtroi, që lidhen me shpenzimet për paga, në zbatim të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, por dhe shpenzimeve për bursat e magistratëve të studentëve të kaluar.

Kjo, kolegë, ishte një panoramë e shkurtër e realizmit të buxhetit të vitit 2023 dhe projektbuxhetit të vitit 2024 për sa i përket Shkollës së Magjistraturës. Ashtu si do të bëjmë me institucionet e tjera, do të rakordojmë me Ministrinë e Financave bashkë me sugjerimet tuaja kolegë, për të konkluduar dhe vlerësuar kërkesat në lidhje me projektbuxhetin e vitit 2024.

Faleminderit!

Klotilda Bushka - Zonja Çausholli, në këtë kuadër nuk ka kërkesa shtesë, pra jemi sipas zërave që ka paraqitur në buxhet qeveria në projektligj.

Zonja Çausholli, a keni diçka për të shtuar?

Vilma Çausholli - Jo.

Klotilda Bushka - Po për çështjen e godinës, zonja Ela, a keni ecur me planin për ambientet e reja, nisur edhe nga diskutimet e bëra në komision kur kemi diskutuar për projektbuxhetin e vitit 2023 në komision?

Ela Qoka – Sa i përket godinës, ne nuk kemi sjellë kërkesë shtesë për këtë vit, sepse na është dakordësuar në rrugë informale, në fakt, ende nuk i kemi dokumentet formale lidhur me asnjë shtesë, që është kërkuar në godinën e Shkollës së Magjistraturës në ambientet aktuale, e cila do të të realizohet nëpërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit. Pra, janë ata që do të operojnë apo ta paraqesin në buxhetin e tyre apo procedurat për këtë kërkesë që shkolla ka bërë gjatë vitit 2023 pranë këtij institucioni dhe pranë qeverisë. Pra, nuk ka kërkesë për një godinë të re, por për një shtesë në ambientet aktuale. Nuk di t’ju them më shumë se deri tani këtë informacion kam.

Klotilda Bushka - Ky diskutim do të mbetet i hapur. Në fakt, unë di që drejtori i shkollës dhe institucionet kanë bërë përpjekje për mjedise të reja, gjithsesi në këtë buxhet nuk ka. Unë ju pyeta vetëm nëse në këtë buxhet do të ishte nevoja e adresimit.

Ela Qoka – Jo, se është Fondi i Zhvillimit që do ta ketë.

Klotilda Bushka - I duhet dhënë zgjidhje sa më parë kësaj çështje, gjithsesi nuk është pjesë e këtij diskutimi për sa kohë nuk ka parashikime buxhetore për vitin 2024.

Faleminderit!

Vijojmë seancën dëgjimore me Komisionin e Prokurimit Publik. Është prezent zoti Fiorent Zguro.

Fiorent Zguro – Përshëndetje!

E nderuar kryetare,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar pjesëmarrës,

Komisioni i Prokurimit Publik i shpreh mirënjohjen Kuvendit për fondin e akorduar sipas projektbuxhetit të vitit 2024-2026. Gjatë vitit financiar, që tashmë po mbyllim, falë mbështetjes së Kuvendit dhe qeverisë së Shqipërisë, Komisioni i Prokurimit Publik është duke zhvilluar fazën e tretë të sistemit të *e-ankesave*. Gjithashtu, institucioni ynë po punon në drejtim të rritjes së bashkëpunimit me institucione e tjera homologe në rajon dhe më gjerë për shkëmbimin e eksperiencave për çështjet e prokurimit publik.

Nga analizimi i projektbuxhetit, të miratuar me vendimin numër 607, 25.10.2023 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e dokumentit të programit buxhetor afatmesëm për vitet 2024-2026, të rishikuar”, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se parashikimet e miratuara nuk pasqyrojnë përmbushjen e nevojave reale të funksionimit të KPP-së për vitin 2024.

Konkretisht do të vlerësonim mundësinë e rishikimit të buxhetit për alokimin e fondeve shtesë në zërat si më poshtë vijon: programi buxhetor afatmesëm 2024-2026, mbështetja buxhetore e parashikuar për KPP-në është në vlerën 79, 5 milionë lekë. Nevoja reale për mbështetjen buxhetore për KPP-në për vitin 2024 vlerësojmë se duhet të jenë në vlerën totale prej 124,2 milionë lekësh. Kjo vjen për zërat si më poshtë:

Te fondet e parashikuara për zërin “Shpenzime personeli”, në programin buxhetor afatmesëm 2024-2026, për vitin 2024 konstatohet se nuk ka ndryshime në fond, krahasuar me buxhetin aktual të vitit 2023. Te tavanet përfundimtare të miratuara nuk reflektohet indeksimi i nivelit të pagave dhe rritja e pagave mbështetur me vendimin nr.325, datë 31.05.2023.

Si rrjedhojë, vlerësojmë nevojën për një shtesë fondesh në masën 30,4 milionë lekë në projektligjin “Për buxhetin e vitit 2024”, në zërin “Shpenzime personeli”, të lidhura drejtpërdrejt me rritjen e tavanit buxhetor për ndryshimin e strukturës dhe nivelit të pagave. KPP-së i janë miratuar tavanet përfundimtare në programin buxhetor afatmesëm 2024-2026 në zërin “Shpenzime personeli” në vlerën 61 milionë lekë. Nevojat reale për këtë zë parashikohen në vlerën 91,4 milionë lekë. Parashikimi i referohet plotësimin të vendeve vakante në strukturë, si dhe nivelit të ri të pagave të miratuara.

Ju sjell në vëmendje se në shkresën me nr. 1756/1, datë 28.09.2023, me lëndën: “Dërgohet analiza e projektprogramit buxhetor afatmesëm 2024-2026, faza II”, Ministria e Financave konfirmon financimin shtesë, i cili është parashikuar si pjesë e reformës së rritjes së pagave dhe këto do të reflektohen në ndryshimet e projektbuxhetit të vitit 2024.

Gjithashtu, sqaroj se në vendimin nr. 25/2023, datë 23.03.2023 të Kuvendit të Shqipërisë “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 65/2020 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimin e pozicioneve të Komisionit të Prokurimit Publik”, është miratuar struktura e KPP-së.

Lidhur me shpenzimet operative (kodi 602 – 606), është parashikuar një tavan buxhetor në vlerën prej 17,5 milionë lekësh, të miratuara në tavanet për periudhën 2024-2026, ku

institucioni ynë vlerëson shtesën e dhënë si të mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve operative për vitin 2024.

Ne kërkojmë një shtesë fondi te fondet e parashikuara për zërin “Shpenzime kapitale”, kodi 231, pasi nuk është parashikuar nevoja për 15,3 milionë lekë, sipas shkresës së prot. nr. 2140, datë 31.08.2023 “Kërkesat buxhetore për periudhën 2024-2026, faza II”, drejtuar Drejtorisë së Buxhetit në Ministrinë e Financave, nga të cilat 7,3 milionë lekë për fazën e III-të të digjitalizimit, pjesë e një kontrate të lidhur, që është kontrata me nr. prot. 73, datë 2.10.2023 me objekt “Digjitalizimi i proceseve të punës për Komisionin e Prokurimit Publik”.

Referuar shkresës nr. 2447, datë 07.11.2022 “Kërkesë për fonde për vitin 2023”, drejtuar Kuvendit, KPP-ja ka parashikuar nevojën për financimin e fazës së III-të për digjitalizimin, projekt i cili shtrihet në 3 vjet buxhetorë (2023, 2024, 2025), i cili është miratuar si pjesë e paketës së buxhetit të vitit 2023, në ligjin nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, duke i akorduar KPP-së vlerën prej 7 milionë lekësh, detyrimet kontraktuale, të cilat lidhen me kontratën nr. 73, datë 02.10.2023 me objekt “Digjitalizimi i proceseve të punës për Komisionin e Prokurimit Publik”. Pra, kërkojmë nga ana juaj të na vihen në dispozicion fondet në vlerën 7,3 milionë lekë, të parashikuara për vitin 2024, për mundësimin e vijimit të këtij projekti.

Gjithashtu, vlerësojmë se kemi nevojë për mbështetje buxhetore në zërin 231 “Shpenzime kapitale” në vlerën 7,3 milionë lekë, gjithashtu dhe një vlerë prej 8 milionë lekësh për “Shpenzime kapitale të patrupëzuara” për pajisjen e KPP-së në lidhje me sistemin e menaxhimit të mbështetur në standardet ISO 37 001.

Në kuadër të proceseve transformuese të mënyrës së ofrimit të shërbimeve për operatorët ekonomikë dhe autoritetit kontraktor, KPP-ja shfaq të nevojshme kryerjen e analizave të vlerësimit të proceseve të punës nga organizma kombëtarë të huaj ose vendas, me synim krijimin e një sistemi të menaxhimit antirryshet, që do të shërbejë gjithashtu edhe për matjen e performancës së institucionit në tërësi, identifikimin e problematikave, me synim adresimin dhe përmirësimin e tyre.

Si përfundim, do të doja t’ju vija në dijeni se KPP-ja ka realizuar gjatë vitit 2022 vlerën prej 49,6 milionë lekësh të ardhura për vendimet e KPP-së, të cilat nuk janë ankimuar në gjykatë, ose vendime të KPP-s, të cilat janë ankimuar, por padia e operatorëve ankimues nuk është pranuar nga gjykata.

Pra, për të dhënë një panoramë të përmbledhur të kërkesave tona, kërkohet një shtesë buxheti në zërin “Shpenzime personeli” në vlerën 30,4 milionë lekë, kjo për të mbuluar nevojat për plotësimin e numrit të strukturës dhe si rrjedhojë e rritjes së pagave dhe indeksimit të pagave. Kërkojmë, gjithashtu, një shtesë prej 15,3 milionësh, që vjen si shumatore e shtesës prej 7,3 milionë lekësh për një kontratë të lidhur tashmë, me nr. 73, datë 2.10.2023 me objekt “Digjitalizimi i proceseve të punës për Komisionin e Prokurimit Publik”; si dhe kërkojmë një shtesë në vlerën 8 milionë lekë në fondin 231, për blerjen e një certifikate ISO 37 001 antiryshfet.

Kjo ishte panorama e përmbledhur e situatës së institucionit tonë.

Ju faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Zguro!

Zoti Xhoxhi, fjala për ju, në mënyrë të përmbledhur, sepse prezantimi ishte shumë i detajuar në shifra. Më pas fjala për zonjën Çausholli, sepse shoh që paska shumë kërkesa, nuk e di në vlerë, por në zëra të paktën.

Klevis Xhoxhi – Faleminderit, zonja kryetare!

Falënderoj përfaqësuesit e Komisionit të Prokurimit Publik për të gjithë prezantimin!

Më lejoni, kolegë, që shkurtimisht t’ju them se buxheti i parashikuar për vitin 2024 për KPP-në është rreth 109 milionë lekë, nga të cilat 90,4 milionë lekë janë shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore; 17,2 milionë lekë janë shpenzime për mallra dhe shërbime; dhe 1 milion lekë janë shpenzime për investime.

Numri i punonjësve për KPP-në për vitin 2024 është parashikuar të jetë 42.

Po të krahasojmë buxhetin e vitit 2023, me projektbuxhetin e vitit 2024, konstatojmë se kemi një rritje prej 19,5 milionë lekësh, ose 22% më shumë. Nga këto, shpenzimet për paga janë rritur në masën 29,4 milionë lekësh ose 48% më shumë; shpenzimet për mallra dhe shërbime kanë një rritje prej 100 mijë lekësh; ndërsa shpenzimet për investime kanë një rënie prej 10 milionë lekësh.

Referuar realizimit të buxhetit për vitin 2023, sipas aktit normativ, për 9-mujorin e parë kemi një realizim për shpenzimet për paga në masën 66%; shpenzime për mallra dhe shërbime në masën 61%; shpenzimet për investime i kemi në nivele të ulëta, në masën 1%.

Për sa u përket kërkesave, përfaqësuesi i KPP-së i bëri të detajuara dhe e vuri theksin për shtesë fondesh për pagesat e fazës së tretë të digjilizimit, një kontrate tashmë të nënshkruar,

pajisjes me standarde ISO 37 001, si dhe disa shtesa për sa i përket fondit të pagave, të cilat në rakordim së bashku me Ministrinë e Financave, do t'i vlerësojmë për t'ia paraqitur më pas Komisionit të Ekonomisë.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Xhoxhi!

Zonja Vilma, fjala për ju.

Vilma Çausholli – Faleminderit, zonja kryetare!

Me sa shoh ka një pasaktësi nga të dhënat e përfaqësuesit të KPP-së, pasi i referohet dokumentit të programit buxhetor afatmesëm, jo projektbuxhetit të vitit 2024, në të cilin janë marrë në konsideratë efektet financiare nga rritja e pagave, si rezultat i reformës së kryer në vitin 2023. Pra, janë plotësuar në shpenzimet e personelit, në projektbuxhetin e vitit 2024, të gjitha nevojat e domosdoshme që kjo strukturë parashikon për këtë vit. Mallrat dhe shërbimet, gjithashtu, nuk patën nevojë apo kërkesë shtesë.

Lidhur me investimet dua të them se, së pari, duhet të kishim një rakordim më të mirë me institucionin, pasi për vitin 2023 janë akorduar 11 milionë lekë investime dhe këto kanë qenë të ndara në: për sisteme *software* 7 milionë lekë; për blerje pajisje zyre elektronike 4 milionë lekë. Ky parashikim, sikurse shihet, në vitin 2023 nuk është realizuar në asnjë nga zërat e tij, ndërkohë që për vitin 2024 kërkojnë 7 milionë lekë të tjera, që, sikurse u tha nga përfaqësuesi, është lidhur një kontratë. Mendoj se një kontratë e lidhur pa pasur fonde buxhetore, nuk duhet të jetë një projekt i ri, mund të bëhet fjalë për të njëjtin projekt, që është parashikuar në vitin 2023 dhe ende nuk është realizuar, meqenëse fondet kanë qenë në dispozicion. Këtë duhet ta sqarojmë dhe të bëjmë një rakordim më në detaje me institucionin, sepse shoh që ky rakordim ka munguar në të gjitha shifrat që u dhanë nga përfaqësuesi i institucionit.

Ky është mendimi dhe vlerësimi ynë.

Faleminderit!

Fiorent Zguro - Mund të shtoj diçka, e nderuar?

Klotilda Bushka – Po, zoti Zguro.

Fiorent Zguro – Lidhur me detyrimet kontraktuale të kontratës nr. 73, datë 2.10.2023, me objekt “Digjitalizimi i proceseve të punës së KPP-së”, kjo ka qenë një procedurë prokurimi e deleguar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për t'u bërë prokurimi deri në

finalizimin e kontratës. Kjo kontratë është lidhur në vitin 2023, në datën 2 tetor. Kështu që, mendojmë se vlera prej 7 milionë lekësh e akorduar do të likuidohet brenda këtij viti buxhetor.

Vlera prej 7 milionë lekësh që kërkohet për vitin 2024, është për të mundësuar vijimin e kësaj kontrate të lidhur tashmë në datën 2.10.2023.

Ndërsa, procesi tjetër, lidhur me vlerën e mobilieve të zyrave, është një proces prokurimi që mendoj se do të realizohet në masën 100% brenda këtij viti buxhetor dhe do të kemi një realizim prej 99% të kësaj procedure.

Kaq kisha, e nderuar.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Zguro!

Duke qenë se po flisni duke iu referuar dy dokumenteve të ndryshme, me sa kuptova nga zonja Çausholli, pasqyrat financiare të projektligjit për buxhetin tregojnë diçka, ndërsa ajo që ju i jeni referuar, është diçka tjetër. Pra, shihini edhe një herë, koordinojini me Ministrinë e Financave, edhe relatorët do ta ndjekin këtë proces, në mënyrë që të kemi një qartësi se çfarë është adresuar dhe çfarë ka ngelur pa adresuar.

Edhe për ju është i njëjti koment që kam për të gjitha institucionet, që është shqetësues me sa shoh për këtë vit, realizimi i investimeve është shumë i ulët nga të gjitha institucionet. Kur flasim për treguesin e ulët të investimeve për vitin aktual, po flasim për investimet për vitin pasardhës dhe, nëse nuk ka një argument të fortë pse kanë ndodhur këto gjëra, me thënë të drejtën, do të duhet ta rimendojmë të gjithë rialokimin e fondeve për investime, që të shkojnë atje ku ka nevojë dhe realizohen, pasi mungesa e kryer e një investimi tregon që nuk paska qenë aq e nevojshme, në qoftë se është lënë pas dore, por në qoftë se ka pasur argumente objektive pse nuk është realizuar, po, kjo është për t'u marrë në konsideratë. Edhe pse nuk jam e fushës për planifikimin e buxhetit, kam kuptuar këto vite nga Ministria e Financave, por edhe nga kolegët, që janë më kompetentë se unë në këtë fushë, që ky është një nga elementet kryesore kur nis analiza për planifikimin buxhetor të vitit pasardhës.

Edhe një herë, nuk paragjykoj askënd, por e kam si shqetësim për të gjitha institucionet, sepse shoh raportet e treguesve të nivelit të realizimit të investimeve. Kështu që, do të duhet që të gjitha institucionet t'i kushtojnë rëndësi kësaj, sepse kjo ndikon në të gjitha punët dhe rezultatet që priten.

Mendoj që këtë dëgjese ta përmbledhim në këtë formë, Ministria e Financave dhe Komisioni i Prokurimit Publik të rakordohen me njëri-tjetrin se sa janë shifrat reale në buxhet, i

cili është objekt i projektligjit që ne kemi në shqyrtim dhe, pastaj shikojini edhe një herë se çfarë janë nevojat, duke u nisur nga më të domosdoshmet.

Gjithashtu, bëni një raport të plotë të treguesve të investimeve reale për vitin 2023, se mua në këto tabela më rezulton shumë i ulët, është për 9-mujorin, e thashë edhe një herë, por gjithsesi duhet ta shikoni edhe me ministrinë dhe sa është mundësia e realizimit të atyre që keni kërkuar, gjithmonë duke u nisur nga parimi i prioritizimit të nevojave më të domosdoshme e kështu me radhë.

Po, zonja Çausholli.

Vilma Çausholli – Do të doja të theksoja se institucioni të mund ta rishohë faktin që edhe shpenzimet operative mund të rialokohen nëse lidhen me investimet. Kërkesa prej 7 milionë lekësh, e paraqitur nga institucioni: duke parë të dhënat ndër vite, rezulton se shpenzimet operative për këtë institucion nga viti 2018 deri në vitin 2022 nuk e kapërcejnë vlerën 10 milionë lekë, ndërkohë që për vitin 2023 janë parashikuar 17,1 milionë lekë. Mund të jetë vendosur një shifër si shpenzim operativ, ndërkohë që duhet të ishte vendosur si investim. Ndoshta duhet të shihet mundësia nga institucioni, se mbase mund të ketë nevojë brenda buxhetit të miratuar për një rialokim mes fondesh. Për këtë do të kërkonim që institucioni të na i paraqesë më të qarta këto kontrata të lidhura, nëse i përkasin fushës së shpenzimeve operative apo fushës së investimeve.

Kjo është për t'u saktësuar.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zonja Çausholli!

Besoj se jeni të qartë. Mendoj se keni nevojë për një sqarim me ministrinë, si fillim, dhe më pas ne, si komision, të jemi në gjendje të vlerësojmë lidhur me ato që rakordoni.

Faleminderit, zoti Zguro!

Kalojmë te dëgjesa e fundit, por jo më pak e rëndësishme, seancë dëgjimore me KQZ-në për shqyrtimin e projektligjit “Për buxhetin e shtetit të vitit 2024”

Për këtë dëgjesë kemi ftuar zotin Ilirjan Celibashi.

Mirë se erdhët, zoti Celibashi!

Përfaqësuesi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në dëgjesën e radhës. do të flasë për projektbuxhetin e vitit 2024.

Zoti Celibashi, nuk po e përsëris, se ju e dini më mirë se unë procedurën, fjala është për ju.

Ilirjan Celibashi – Faleminderit, zonja kryetare!

Do të përpiqem të jem konciz në prezantimin e kërkesave shtesë nga ana e institucionit të KQZ-së, po kështu edhe me argumentet.

Në lidhje me zërin “shpenzime personeli, paga dhe sigurime shoqërore”, ne kemi kërkuar një shesë fondi prej 16,1 milionë lekësh. Kjo shtesë fondi lidhet me rekrutimin e 70 punonjësve me kohë të pjesshme, të cilët do të angazhohen në procesin e hapjes së kutive të votimit të zgjedhjeve të 14 majit të vitit 2023, është një proces teknik, i cili është i detyrueshëm për shkak të parashikimeve të Kodit Zgjedhor, që lidhen me administrimin e materialeve zgjedhore pas përfundimit të procesit zgjedhor.

Gjithashtu, kostoja për pagesën e këtyre 70 punonjësve është 9,5 milionë lekë; janë dhe 6,6 milionë lekë që lidhen me pagesën e 10 punonjësve të tjerë, të cilët do të merren me kohë të pjesshme dhe do të angazhohen në procesin e sistemimit dhe arkivimit të dokumentacionit zgjedhor, jo vetëm të atij të zgjedhjeve të 14 majit 2023, por edhe të zgjedhjeve të shkuara. Është një detyrë e lënë nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivit në lidhje me sistemin dhe arkivimin e këtij dokumentacioni, i cili ndër vite ka ngelur i paorganizuar, i pasistemuar, pra është një detyrim që buron nga ligji për arkivat për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për ta sistemuar këtë dokumentacion dhe një pjesë të tij për ta depozituar në Arkivin Qendror të Shtetit. Është kërkuar një shtesë në zërin “mallra dhe shërbime” prej 111,1 milionë lekësh; 31 milionë lekë lidhen me shërbime të teknologjisë së informacionit, si mirëmbajtje të programeve dhe të harduerëve dhe licencave; 81,1 milionë lekë lidhen me shërbime për mirëmbajtje sigurie dhe shpenzime qiraje për ambiente të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përfshi këtu edhe magazinat e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve; janë kërkuar 0,7 milion lekë në zërin “shpenzime për transfertat korrente të huaja”. Kjo shumë kërkohet për pagesën e disa *fee*-ve të anëtarësisë që paguan Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në disa organizata ndërkombëtare ku marrim pjesë. Kemi kërkuar një fond prej 763,7 milionë lekësh në zërin “shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, pra investime, nga të cilat 590 milionë lekë lidhen me ndërtimin e një shtese magazine për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve; 41 milionë lekë është projekti; 40 milionë lekë janë programe kompjuterike, të cilat lidhen me ruajtjen dhe administrimin e pamjeve filmike të procesit zgjedhor të zhvilluar në qendrat e votimit. Është një detyrim, i cili

buron për KQZ-në nga Kodi Zgjedhor. 34 milionë lekë janë për digjitalizimin e sistemit të administrimit të materialeve zgjedhore në magazinë, 19 milionë lekë janë për përgatitjen e hartave të qendrave të votimit dhe komponentëve të tjerë, të cilët lidhen me informacionin për qendrat e votimit. Edhe kjo kërkesë rrjedh nga një detyrim i Kodit Zgjedhor, pra detyrim i KQZ-së për të përgatitur hartat e qendrave të votimit; janë 50 milionë lekë, nga gjithë e shtesa prej 763,7 që ne kërkojmë, të cilat lidhen me ndërtimin e disa moduleve dhe në përgjithësi me digjitalizimin e disa proceseve të punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Këto janë përmbledhtazi kërkesat e KQZ-së për programin buxhetor vjetor të vitit 2024.

Ndërkohë, i kemi paraqitur një kërkesë Ministrisë së Financave, respektivisht edhe qeverisë, në lidhje me programin “Zgjedhjet e përgjithshme dhe ato lokale”. Edhe pse zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin e Shqipërisë do të zhvillohen pritsmërisht në vitin 2025, ne kemi vlerësuar që ka elemente të përgatitjes së këtij procesi, të cilat lidhen me veprimtarinë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në vitin 2024, rrjedhimisht duhet që një pjesë e këtyre shpenzimeve t’ia mundësohen Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në vitin 2024.

Shumë shkurt në lidhje me këtë program buxhetor: ne kemi bërë një parashikim prej rreth 6,4 miliardë lekësh në total për të gjithë procesin e zgjedhjeve të vitit 2025 dhe kemi kërkuar që 67,1% e këtij buxheti t’i mundësohet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në vitin 2024. Dua të sjell në vëmendje që pjesën më të madhe të këtyre kërkesave e zë blerja e pajisjeve të votimit dhe numërimit elektronik, por duhet të themi se kjo është një çështje që thjesht e kemi futur në parashikimin buxhetor për zgjedhjet e vitit 2025, por është një çështje, sikurse ju ndoshta më mirë se unë e dini, e një diskutimi të gjerë politik ndërmjet partive politike dhe qeverisë për domosdoshmërinë ose jo të shtrirjes së procesit të votimit dhe numërimit elektronik. Duke zbritur këtë kosto, ajo çfarë ne vlerësojmë pastaj përbën shpenzimet normale në kuadër të përgatitjeve të zgjedhjeve të vitit 2025 dhe një pjesë e këtyre fondeve duhet të çelen në vitin 2024, konkretisht: 20,8 milionë lekë për paga, kontribute dhe sigurime shoqërore për personelin e përkohshëm që do të rekrutohet. Janë 33,9 milionë lekë për procesin e trajnimit të komisioneve të niveleve të ndryshme, duke përfshirë këtu edhe vetë programin e trajnimit të trajnerëve; 85,7 milionë lekë kërkohet të livrohen për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2024, në kuadër të zgjedhjeve të vitit 2025; 15,5 milionë lekë për materiale të ndryshme zgjedhore; 15 milionë lekë për prodhime të materialeve që lidhen me edukimin e zgjedhësve; 20,3 milionë lekë për shërbime të teknologjisë së informacionit; 17,7 milionë lekë për shërbime

që lidhen me fushatën edukuese dhe sensibilizuese; 7,9 milionë lekë shërbime të telefonisë dhe internetit dhe transmetime të ndryshme; 9,4 milionë lekë shërbime transporti e të tjera.

Në zërin “shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, pra investime, thashë që 3,9 miliardë lekë lidhen me blerjen e pajisjeve elektronike të votimit dhe numërimit; 48 milionë lekë lidhen me një shtesë në numrin e pajisjeve të identifikimit elektronik (janë rreth 110 mijë pajisje të identifikimit elektronik shtesë që ne kërkojmë të blihen), të cilat kapin një vlerë 48 milionë lekë, janë 225 milionë lekë për platformën elektronike të regjistrimit të votuesve nga jashtë, por edhe kjo është një çështje që, së pari, duhet të ezaurojë diskutimin politik, por edhe atë institucional në Kuvend; janë 14 milionë lekë që lidhen me rikonstruksionin e sallës aktuale të serverëve dhe të rrjetit të brendshëm të KQZ-së. Pra, pak a shumë, këto janë kërkesat, nuk e di se sa konciz isha, por u përpoqa të isha i tillë.

Klotilda Bushka – Shumë i qartë.

Më njofton sekretaria se ju e keni sjellë edhe shkrim kërkesën.

Ilirjan Celibashi – Po, kam çuar me shkrim një listë të të gjitha kërkesave, bashkë me argumentet pse i kërkoj këto shtesa.

Klotilda Bushka – Kërkesa e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Komisionit të Prokurimit Publik që ka ardhur po sot t’u shpërndahet të gjithë anëtarëve të komisionit, si çdo material tjetër.

Zoti Xhoxhi, shkurtimisht, sepse zoti Celibashi ishte shumë i detajuar dhe më pas zonja Çausholli.

Klevis Xhoxhi – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zoti Celibashi, për prezantimin e projektbuxhetit!

Më lejoni, kolegë, të theksoj se buxheti i parashikuar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2024 është rreth 300 milionë lekë, nga të cilat 168 milionë lekë janë shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore; 44,2 milionë lekë janë shpenzime për mallra dhe shërbime; 48,2 milionë lekë janë transfertat për buxhetet familjare dhe 38,8 milionë lekë janë shpenzimet për investime. Numri i punonjësve për vitin 2024 është parashikuar të jetë 95 punonjës. Po të bëjmë krahasimin me buxhetin e vitit 2023 sipas aktit normativ, kemi një rënie prej 11% , ku vetëm shpenzimet për paga janë rritur 40 milionë lekë ose 31% më shumë, shpenzimet për mallra dhe shërbime kanë një rritje me 700 mijë lekë ose 2% më shumë,

transferta ka një rënie me 1 milion lekë dhe shpenzimet për investimet kanë një rënie me 78 milionë lekë.

Zoti Celibashi i parashtroi edhe kërkesat që ka bërë pranë Komisionit të Ligjeve mbi tavanet buxhetore të parashikuara në projektligjin “Për buxhetin e vitit 2024”, të cilat konkretisht synojnë shtesë në zërin “shpenzime për paga” në vlerën 60,1 milionë lekë; shtesë në zërin “investimeve për mallra dhe për shërbime” në vlerën 111,1 milionë lekë; shtesë në zërin “shpenzime në transfertat korrente të huaja” për pagesën e kuotës së anëtarësimit vjetor pranë Shoqatës Botërore të Trupave të Menaxhimit të Zgjedhjeve; shtesën në zërin e investimeve në vlerën e 763,7 milionë lekë. Gjithashtu, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka parashtruar kërkesën për shtesa fondesh për parapërgatitjen për zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2025, konkretisht në vlerën prej 4,34 miliardë lekësh, ku shpenzime për personelin janë 54,7 milionë lekë, shpenzime për mallra dhe shërbime janë 85,7 milionë lekë.

Kolegë, pak a shumë, këto ishin në formë të shkurtër, pasi përfaqësuesi i Komisionit të Qendror të Zgjedhjeve bëri një panoramë më të detajuar për sa u përket kërkesave të institucionit në lidhje me shtesat për fonde mbi tavanet buxhetore. Në rakordim me Ministrinë e Financave dhe me sugjerimet e kolegëve t’i vlerësojmë dhe t’ia sugjerojmë Komisionit të Ekonomisë.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Xhoxhi!

Zonja Çausholli.

Vilma Çausholli – Faleminderit, zonja kryetare!

Mendoj se buxheti i akorduar për vitin 2024 për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve i përmbush nevojat e domosdoshme për funksionimin e këtij institucioni, ndërsa kërkesat shtesë vlerësoj se janë të konsiderueshme dhe për plotësimin e tyre duhet të gjenden burime të tjera financiare ose duhet të ribëhen rialokime brenda këtij buxheti të miratuar. Për këtë arsye mendoj se kjo do të jetë në vlerësimin tuaj për një vendimmarrje të mëtejshme. Faleminderit!

Klotilda Bushka – Cili nga kolegët e do fjalën? Nuk ka kërkesë.

Në lidhje me shtesat buxhetore, njëherë, zoti Celibashi, unë sot po i shikoj me detaje zërat e proceseve zgjedhore, por zgjedhjet paskan kosto shumë të larta, pjesën më të madhe e marrka ana e organizmit të proceseve nëpërmjet mjeteve elektronike, të digjitalizimit pajisje etj.,! Tani, në qoftë se duhet të diskutohet për mbarëvajtjen e zgjedhjeve të vitit 2025 në zërat

buxhetorë të vitit 2024, unë do t'ju nxisja që ju si Ministri e Financave dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të bënit një diskutim paraprak, para se ne të vendosim, sepse kjo duhet të sqarohet.

Për sa u takon shtesave të tjera, ato që janë të domosdoshme, besoj se duhet t'i diskutoni me relatorët, të ecni, siç e keni thënë deri tani, të gjitha institucionet në kuadër të prioritizimit dhe të mundësive të projektbuxhetit. Në këtë moment ne nuk jemi dot në gjendje të bëjmë një diskutim për këto kërkesa. Pra, unë do t'i lutesha Ministrisë së Financave dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të shikonin mundësinë e sqarimit të shtesave, qoftë edhe nëpërmjet rialokimit brenda zërave buxhetorë, siç thotë zonja Çausholli; cilat janë të nevojshme dhe relatorët ta ndjekin këtë proces, derisa të vijë momenti i shqyrtimit nën për nën, sepse janë shumë detaje, për të cilat ne tani nuk jemi gati të bëjmë një diskutim. Dakord?

Iirjan Celibashi – Unë jam plotësisht dakord, zonja kryetare, për këtë qasje.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Celibashi!

Kolegë, a keni ndonjë diskutim tjetër? Nuk keni.

Zoti Xhoxhi? Jo.

Zonja Çausholli?

Atëherë, rrimë në këtë linjë, siç kemi vendosur për dëgjesat e tjera të institucioneve.

Kolegë, edhe për sot ne i kemi mbaruar dëgjesat. Unë do t'i falënderoj të gjithë të ftuarit, zonjën Çausholli, relatorët, kolegët dhe stafin e Kuvendit, IT-në për realizimin e kësaj mbledhjeje!

Ju uroj të gjithëve një fundjavë të mbarë dhe shihemi javën tjetër! Gjithë të mirat!

Mbledhja mbyllet.

MBYLLET MBLEDHJA